Nr. 4632/1 Prot
Dt. 15.08.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT SHKODER**

Nr.529/1 prot.

Shkodër, më 09 .08.2024

**Lënda:** Mbi Vendimin Nr. 52-53, datë 29.07.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr.139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", neni 9, pika 1, nënpika 1.7, shkronja "b", neni 54, shkronja "ll", neni 55, pika 2, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2014 "Për sistemin e adresave", i ndryshuar, neni 3 dhe 6, shqyrtoi VKB Vau Dejës Nr. 52-53, datë 29.07.2024 *"Për ndryshim dhe emërtim rruge në fshatin Mjedë & qyteti Vau Dejës-Bashkia Vau Dejës"*, akte me karakter jo normativ.
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKT**

**Majlinda ANGONI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
**KESHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr.53 Datë 29.07.2024**

*Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 20, neni 23, neni 54 germa ll, ligji nr 9270 date 29.07.2004 ndryshuar,*
Si dhe pas shqyrtimit të Projekt - Propozimit paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike, **Nr. 4 date 18. 06. 2024** miratuar nga Kryetari i Bashkise, inicuar me kërkesë të banorëve të lagjes perkatese ne qytetin Vau dejes, ku kërkohet ti ndryshohet emërtimi i nje segmenti te rruges prej 125 m *" Don Nikolli"*, sipas hartes bashkelidhur dhe te emertohet rruga " Gjerardo Tushi".

**Këshilli Bashkiak, pas diskutimit dhe miratimit me shumice te votave:**

**VENDOSI:**

**1.**Të jepet miratim per ndryshim te emërtimit të segmentit te rrugës :

| Nr. Rruge | Emri I segmentit te rruges eshte: | Behet: |
|---|---|---|
| 03360024 | Don Nikolli | Gjerardo Tushi |

**2.**Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit te Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike per zbatimin e vendimit, si dhe nepunesi i menagjimit te sistemit te adresave per reflektimin e ndryshimeve perkatese

**3.**Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"(ndryshuar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

**Kryetar Këshilli**

**Ervis Shimaj**

**Sekretar Këshilli**

**Ardian Celepija**

Miratuar me 16 vota
Vota pro 16
Vota kunder –
Vota abstenim –
Zbardhur me date 01/08/2024

*Adresa: Rruga" Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006,* ***web:*** *www.vaudejes.gov.al,* ***e-mail:*** *info@vaudejes.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT, KADASTRES DHE INVESTIMEVE PUBLIKE**

Nr.______prot. Vau Dejes, më___.___.2024

**Projekt – Propozim**
**Nr. 4 Date : 18/ 06/ 2024**

**"Për ndryshimin e emertimit të segmentit të rrugës Don Nikolli ne Gjerardo Tushi, lagjia e pallateve, qyteti Vau Dejes ".**

*Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"neni 20, (*Neni 20: ***E drejta e iniciativës qytetare*** 1. *Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendor)neni 23,(* Neni 23 Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, pika 4. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe sheshеve publike vendore. )neni 54(Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak germa* ll) ***vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;)*** *, ligji nr 9270 date 29.07.2004 " Per sistemin e Adresave" ndryshuar,neni 3* . ***Emërtimi i bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve bëhet me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen.*** Neni 4/1 (Shtuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008) 1**. *Çdo njësi e qeverisjes vendore krijon, përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave*.***Shkresen e Ministrisë së Brendshme Nr. 419 Prot date 11.02.2020, Shkresen e Ministrisë së Brendshme Nr. 3067 Prot date 07.12.2020 , Si dhe nisur nga kerkesa e banoreve te lagjes Pallate Nr. Praktike 1287 date 07.06.2024:*

**PROPOZOJME**

- Të ndryshohet emërtimi i segmentit te rrugës:

| Nr. Rruge | Emri i rruges është: | Propozohet: |
|---|---|---|
| 03360024 | Don Nikolli | Gjerardo Tushi |

- Pas Miratimit nga Këshilli Bashkiak, Vendimi do ti dërgohet Prefektit të Qarkut Shkodër.
- Ne vijim Vendimi per ndryshimin e emertimit te rruges se mesiperme do ti kaloje për zbatim nepunesit pergjgjes per sistemibn e adresave prane Bashkise Vau Dejes.

*(Bashkëlidhur kërkesa e banoreve, harta përkatese dhe relacion i detajuar)*

Juriste: Dorina Lekaj
Ing. Armand Velaj

**KRYETARI**
**KRISTIAN SHKRELI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

# PLANVENDOSJA E RRUGES

https://geoportal.asig.gov.al
Data e Printimit: 19.06.2024.

469880.096
4652504.307

470127.336
4652504.307




N

469880.096
4652347.227

470127.336
4652347.227

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH

0 25 50 m

https://geoportal.asig.gov.al:ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT, KADASTRES DHE INVESTIMEVE PUBLIKE**

Nr.______prot.                                                                 Vau Dejes, më___.___.2024

**Lenda : Relacion sqarues " Mbi ndryshimin e emertimit të një segmenti të rrugë në QYTETIN Vau Dejes, Bashkia Vau Dejes".**

Pranë Bashkisë Vau-Dejës kanë paraqitur kërkesë disa banorë të lagjes "Pallate" të qytetit Vau-Dejës, të cilët kanë kërkuar ndryshimin e emërtimit të një segmenti të rrugës të emërtuar "Rruga Don Nikolli" në emërtimin "Rruga Gjerardo Tushi" ndodhur në lagjen "Pallate" në këtë qytet.
Disa nga banorët e kësaj lagjeje kanë depozituar dhe kanë dhënë dhe sqarimet e mëposhtëme:
Emërtimi i disa segmenteve të rrugëve në këtë lagje të emërtuar "Rruga Don Nikolli" është i pranishëm dhe nuk kanë ndonjë pretendim për këtë emërtim nuk është bërë gabim dhe nuk kërkojnë të hiqet ky emërtim në të gjithë segmentet ku rruga mban këtë emërtim, por propozimi i tyre qëndron për t'i dhënë një segmenti një emertim të ri.
Ky segment është 125 m dhe nga "Rruga Don Nikolli" dhe propozohet t'i vendoset "Rruga Gjerardo Tushi".
Ky propozim vjen si kontrubut i vazhdueshëm i prindërëve të të ndjerit Gjerardo Tushi, ku nëna e tij, Audorela Tushi është mësuese në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Lucjan Avgostini" prej 29 vitesh duke dhënë kontributin e saj për arsimimin e brezave të ndryshëm dhe babai i tij Gëzim Tushi me gradën Major me detyrë Komandant në Repartin Ushtarak nr. 1011, në batalionin e parë të këmbësorisë, Vau Dejës, vetë personalisht dhe me efektivin ku drejton, duke dhënë kontribut në komunitet në rastet e fatkeqesive natyrore të ndodhura në komunitet, në vitin 2010 dhe në vitet e tjera në përmbytje, në zhbllokimin e rrugëve nga dherat si rezultat i reshjeve të shiut dhe nga reshjet e dëborës duke bllokuar akset e Bashkisë Vau-Dejës dhe më gjërë si dhe në rastin e tërmetit në vitin 2019. Kjo tregon se janë familje model dhe kontribues real në të gjithë komunitetin.
Mbi të gjitha ky propozim vjen për t'i mbajtur gjallë emrin e fëmijës së tyre të vetëm Gjerardo Tushi, i cili pas një beteje për 9 muaj me një sëmundje të rëndë "leucemi akute" ka humbur betejën dhe ka ndërruar jetë.
Gjerardo Tushi, ka përfunduar shkollën 9-vjeçare në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Lucjan Avgostini" në vitin 2015. Më pas ka ndjekur shkollën e mesme në Gjimnazin privat ''Atë Pjetër Mëshkalla''në Shkodër nga viti 2015-2018. Pas rezultatetve të shkëlqyera është regjistruar dhe ka përfunduar studimet në Universitetin e Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, dega "teknike Imazherie" Bachelor nga muaji tetor 2019 deri në mujain korrik 2022. Edhe këtu ishte një student i shkëlqyer dhe ndërkohë ishte zotërues i gjuhëve të huaj atë të gjuhës angleze (Aptis) në nivelin C dhe gjuhës gjermane (Test DaF) në nivelin TDN5 / C. Ka pasur aftësi shumë të mira për planifikim, organizim dhe menaxhim, si dhe njohuri shumë të mira në kompjuter të programeve word, exel, power point, gjithashtu herë pas herë ka kryer shërbim komunitar.
Ëshë regjistruar në vitin e parë në master shkencor në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë në vitin 2022 ku dhe kryente praktikë në spitalin rajonal Shkodër dhe në qendrën shëndetësore Vau Dejës, shoqëronte dhe pesonel mjekësor kur në komunitet kanë ardhur nga Tirana për të kryer

Ekzaminimet për banorët për mamografi.
Në mujin mars 2023, i ndërpreu studimet ku gjatë ekzaminimeve mjekësore që i duheshin për tu përballur gjatë terapisë më sëmundjen e tij të rëndë onkologjike. Njohuritë të cilat i kishte përfituar gjatë studimeve ju nevojiten që së bashku me mjekët specialistë vendas dhe të huaj, të bashkëpunonte me to si një "koleg i ri", por energjik për të luftuar sëmundjen vet dhe të rëndë. I ndihmonte mjekët dhe gjatë bisedave me to i thonin që të rrinte e të vazhdonte pune si mjek radiolog në Turqi apo itali, por jo ai duke buzëqeshur ju thonte se pas shërimit, do të shërbej në Shqipëri dhe do t'I shërbej qytetarëve të mi. As sëmundja nuk mundi të ja ndërpriste vullnetin e tij për të mësuar ku gjatë kësaj lufte për jetën mësoi në mënyrë të shkëlqyer gjuhën e tretë, atë italiane.
Gjerardo Tushi ishte dhe një aktivist i dalluar dhe në organizmet që bënte Dioqeza e Sapës gjatë aktiviteteve të tyre duke bashkëpunuar dhe duke u bërë pjesë e rëndësishme e këtyre organizimeve, duke qenë si fëmijë model i kësaj Dioqeze, siç janë shprehur dhe drejtuesit e saj.

Gjithashtu sqarojme se Bashkia Vau Dejes, ka ndërhyre per ndryshim emertimi te rrugeve edhe ne raste te tjera pasi ka marre ankesa nga banore per emertime te rrugeve me emra qe banoret as nuk e dinin dhe nga vete fshati apo lagjia emrërtohej me një tjeter emer.
Kjo ka ndodhur kryesisht kur Në vitin 2011 INSTAT ka realizuar Censusin e Popullsise dhe Banesave në Shqipëri , dhe në vijim kur u bë bashkimi i Sistemit të Adresave me Sistemin e Gjendjes Civile në të gjithë Republiken e Shqipërise ka ndodhur fenomeni i mosperputhjes së adresave të banoreve me pasaportizimin e gjendjes civile, ku ka rezultuar një koplaps për gjithë adresat e banoreve të cilet jetojnë apo punojnë në një qytet tjeter apo Bashki tjetër nga ajo ku kanë Gjendjen Civile.
Duke qënë se censusi i ka gjetur në një zone të caktuar u ka dërguar automatikisht edhe adresen aty.
Të ndodhur në keto rrethana, dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr 9270 datë 29.07.2004 ndryshuar si dhe nga shkresa e Ministrisë së Brendshme Nr. 419 Prot datë 11.02.2020, ka nisur puna intensive nga Gjendja Civile si dhe nga Drejtoria e Planifikimit te Territorit ku është ngritur struktura për Menaxhimin dhe Sistemimin e Sistemit të Adresave nga ing. përkates.
Ndryshimi dhe sistemimi i adresave bëhet kur banori paraqitet në Institucion me dokument identifikimi apo pronësie, dhe gjate proçedures ka rezultuar se shume lagje mbajne emertime për të cilat banoret nuk i njohin dhe nuk bien dakort, dhe kërkojne të vendosen emertimet e rrugëve siq ata i njohin prej shumë kohësh.
Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për të përligjiur proçeduren dhe për të qenë sa më bashkëpunuese dhe asnjeanese me banoret ka kerkuar nga banoret që nuk bien dakort me emertimet e rrugeve dhe kërkojne ndryshimin e tyre , që proçedura të kryhet me dakortesine e lagjes ku do te behet ndryshimi i rrugës dhe të kalohet për Vendim në Keshillin Bashkiak si enti pronar i cili ne zbatim *te Neni 54 Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak , germa ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkise.*

***Konc. Dorina Lekaj***

***Antonio Pjetraj***

Adresa: "Rruga Qafa e Gurit" Vau Dejes, Telefon/Faks 00355 2612 0006 , e-mail: info@vaudejes.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vau Dejes

Vau dejes, më 06.08.2024

**Propozim**

**Për ndryshimin emërtimit te rruges "Don Mhilli" dhe emertimin rruga "Gjerardo Tusli"**

**Drejtuar: Kryetarit te Bashkise vau dejes z. Kristian Shkreli.**

**Drejtuar: Keshillit Bashkiak Vau Dejes**

*Ne banoret e lagjes " PALLATE ", gyteti vau dejes, Bashkia Vau Dejes, kerkojme te ndryshojme emertimin e ruges si me poshte:*

| Nr. Rruge | Emri I rruges eshte: | Propozohet: |
|---|---|---|
| 03360024 | Don Mhilli | Gjerardo Tusli |
| | | |

Banoret:

Juli Marku J20731054G
Luan Biba I10306045B
Mark Topolli F80917059C
Ndue Boçaj G40707094A
Ndoc Ndoci J20613068C
Artiola Ndoci J75521026B
Marije Topolli G05929072A
~~Flora Ndoci H15130194T~~
Hajri Hoxha H31108021I
Aleks Froku I80701049E

| | | |
|---|---|---|
| Meliha | Zyberaj | G65506076D |
| Regjina | Rrethotari | G75313081A |
| Mexhide | Ndreka | F25707014N |
| Franga | Jkola | H05607120V |